



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

**Nr.5**

**2006**

**7 shkurt**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.4760 datë 1.2.2006	Për emërim ambasadori .....	79
Dekret nr.4761 datë 1.2.2006	Për emërim ambasadori .....	79
Vendim i KM nr.43, datë 27.1.2006	Për shmangien e nepotizmit dhe ndikimit të pushtetit në rekrutimin dhe karrierën e personelit të administratës tatimore.....	80
Vendim i KM nr.44, datë 27.1.2006	Për shmangien e nepotizmit në administratën publike.....	84
Vendim i KM nr.47, datë 27.1.2006	Për një ndryshim në vendimin nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, të ndryshuar .....	86
Vendim i KM nr.48, datë 27.1.2006	Për disa shtesa në vendimin nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.....	87
Vendim i KM nr.52, datë 27.1.2006	Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Çmimeve të Barnave .....	91
Vendim i KM nr.56, datë 1.2.2006	Për ndryshimin e përbërjes së Këshillave të Përfaqësuesve të Bordeve të Kullimit, në zonat e shërbimit të kullimit.....	92
Udhëzim i KM nr.2, datë 27.1.2006	Për një shtesë në udhëzimin nr.1, datë 1.1.1996 të Këshillit të Ministrave “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.....	92

**DEKRET**  
**Nr. 4760, datë 1.2.2006**

**PËR EMËRIM AMBASADORI**

Në mbështetje të nenit 92 pika dh dhe nenit 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit

**DEKRETOJ:**

Neni 1

Zoti Admirim Banaj emërohet në detyrën e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë të Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Arabisë Saudite.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Alfred Moisiu**

**DEKRET**  
**Nr. 4761, datë 1.2.2006**

**PËR EMËRIM AMBASADORI**

Në mbështetje të nenit 92 pika dh dhe nenit 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit

**DEKRETOJ:**

Neni 1

Zoti Bujar Skëndo emërohet në detyrën e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Bullgarisë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Alfred Moisiu**

**VENDIM**  
**Nr. 43, datë 27.1.2006**

**PËR SHMANGIEN E NEPOTIZMIT DHE NDIKIMIT TË  
PUSHTETIT NË REKRUTIMIN DHE KARRIERËN E PERSONELIT  
TË ADMINISTRATËS TATIMORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 9 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të pikave 1 e 2 të nenit 3 të ligjit nr.9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, me propozimin e Kryeministrit Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Rekrutimi i personelit në administratën tatimore kryhet nëpërmjet përzgjedhjes me konkurrim sipas kriterëve ligjore dhe procedurave të përcaktuara në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Konkurrentët ose personeli tatimor për detyrat: punonjës të nivelit të lartë, të mesëm e të ulët drejtues, punonjës ekzekutivë e punonjës të Policisë Tatimore, skualifikohen ose humbin të drejtën e vendit të punës, në rast se për ta ekzistojnë apo, pas emërimit, linden shkaqet ligjore të papajtueshmërisë për shkak të:

- a) lidhjeve nepotike ose
- b) lidhjeve nepotike me pushtetin.

3. Lidhjet nepotike janë lidhjet e mëposhtme ndërmjet konkurrentëve apo personelit tatimor të kategorive të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, me të gjithë personelin tatimor, deri në nivelin e drejtuesit të institucionit ku bëjnë pjesë, si dhe me drejtorët, deri në nivelin e titullarit të institucionit epror:

- a) lidhje familjare: bashkëshort/bashkëjetues, bir, bijë dhe fëmijët e tyre;
- b) lidhje gjinie: prindër, motër a vëlla dhe fëmijët e tyre, emtë a ungj;
- c) lidhje krushqie: prind, fëmijë, vëlla/motër i/e bashkëshortit/es, si dhe bashkëshort/bashkëjetues i fëmijëve.

“Bashkëjetues”, sipas shkronjave “a” e “c”, të kësaj pike, është personi i cili cilësohet i tillë sipas nenit 163 të ligjit nr.9062, datë 8.5.2003 “Kodi i familjes”.

4. Lidhje nepotike me pushtetin ekzistojnë apo linden kur konkurrentët apo personeli i administratës tatimore, i kategorive të përcaktuara në pikën “2” të këtij vendimi, kanë apo krijojnë lidhje të tilla, sipas përcaktimeve në shkronjat “a”, “b” e “c” të pikës “3” të këtij vendimi, me:

- a) Presidentin e Republikës dhe stafin e tij politik;
- b) Kryeministrin, zëvendëskryeministrin, ministrat dhe zëvendësministrat;
- c) anëtarët e stafit politik të Kryeministrit dhe Ministrit të Financave;
- ç) deputetët;
- d) titullarët e institucioneve të Avokatit të Popullit, Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Prokurorisë së Përgjithshme;
- e) titullarët e institucioneve qendrore, të pavarura;
- ë) titullarët e institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit dhe të Ministrit të Financave;

f) drejtuesin e Policisë së Shtetit dhe zëvendësit e tij;

g) prefektin, kryetarin e bashkisë, kryetarin e këshillit bashkiak dhe të këshillit të qarkut, kryetarin e gjykatës së rrethit gjyqësor, prokurorin e rrethit gjyqësor, drejtorin e policisë së qarkut, për administratën tatimore, që vepron brenda territorit përkatës.

5. Konkurrentët fitues në kategoritë e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, para fillimit të marrëdhënies së punës, deklarojnë lidhjet nepotike, sipas pikave 3 e 4 të këtij vendimi. Kur konkurenti fitues ka lidhje nepotike apo lidhje nepotike me pushtetin, sipas pikave 3 e 4 të këtij vendimi, skualifikohet, si i papajtueshëm për të kryer detyrën.

6. Drejtoria e personelit, para kryerjes së testimit për çdo vend pune, vendos në dispozicion të konkurrentëve të dhënat për identitetin e personelit të institucionit, si dhe për identitetin e drejtorëve deri në nivelin e titullarit të institucionit epror, për pozicionin vakant të punës.

7. Personeli i administratës tatimore, i kategorive të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, ka për detyrë të rideklorojë lidhjet nepotike a lidhjet nepotike me pushtetin të krijuara rishtazi, brenda 2 javësh nga lindja e detyrimit, sipas kësaj pike. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka të drejtë të ngarkojë drejtorinë e personelit të kryejë verifikimin e deklarimeve, kur ka të dhëna të besueshme për paraqitje rrethanash të rreme në to.

8. Verifikimi i parë i lidhjeve nepotike dhe lidhjeve nepotike me pushtetin bëhet brenda 6 javësh kalendarike nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Në verifikimin e parë, punonjësit duhet të deklarojnë lidhjet nepotike me pushtetarët, sipas listës së funksioneve të paraqitura në pikën 4 të këtij vendimi, në çastin e deklarimit dhe, në rast se rekrutimi i tyre është bërë në një periudhë jo më herët se katër vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, edhe me pushtetarët, sipas listës së funksioneve të paraqitura në pikën 4, në çastin e rekrutimit. Ekzistenca e lidhjeve nepotike a lidhjeve nepotike me pushtetin, sipas kësaj pike, përbën shkak për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.

9. Punonjësit e administratës tatimore, të skualifikuar sipas këtij vendimi, në çastin e liritimit nga detyra, përfitojnë, nëse kanë mbi 3 vjet vjetërsi pune të vazhdueshme në këtë institucion, një shpërblim financiar të barabartë me pagën e një 15-ditëshi, për çdo vit pune të plotë, që llogaritet në bazë të pagës, që ka në përfundim të marrëdhënieve të punës.

10. Punonjësit e administratës tatimore, të kategorive të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, dorëzojnë në drejtorinë e personelit të institucionit deklaratat e plotësuara për lidhjet nepotike ose lidhjet nepotike me pushtetin, sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

11. Ngarkohet Ministri i Financave që, brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore për zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Në mbështetje të ligjit nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumente zyrtare” ky dokument është i hapur për publikun. Unë, deklaruuesi jam në dijeni të detyrimit për rideklarim rishtazi, sipas pikës 7, të lidhjeve familjare, të gjinisë a të krushqisë, me rrethin e personave të caktuar në vendimin nr.43, datë 27.1.2006, sapo të ndryshojë ndonjë rrethanë.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCËS  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE**

**Formular deklarimi:**

**Deklaruesi:** \_\_\_\_\_

**Pozicioni:** \_\_\_\_\_

**Vendi i punës: (Drejtoria /Sektori)** \_\_\_\_\_

**Seksioni I**

**Lidhje familjare, të gjinisë a të krushqisë  
me punonjës të tjerë të administratës tatimore**

Në mbështetje të detyrimeve në fuqi, vendimit nr.43, datë 27.1.2006 të Këshillit të Ministrave “Për shmangien e nepotizmit dhe ndikimit të pushtetit në rekrutimin dhe karrierën e personelit të administratës tatimore”, unë, nënshkruesi \_\_\_\_\_, kandidat për t’u/i (emër, atësi, mbiemër) punësuar pranë kësaj administrate, në detyrën \_\_\_\_\_, niveli \_\_\_\_\_, i punësuar në \_\_\_\_/\_\_\_\_/200\_\_\_\_, nën përgjegjësinë time të plotë (data, muaji, viti)

deklaroj se, \_\_\_\_\_ lidhje familjare, të gjinisë a të krushqisë me personelin e administratës tatimore brenda rrethit të personave të përcaktuar në pikën 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.43, datë 27.1.2006,

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**Kjo deklaratë është hartuar me të  
dhënat në ditën e deklaramit**

\_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_/200\_\_\_\_

**Nënshkrimi:** \_\_\_\_\_

DEKLARATA PLOTËSOHET NGA DEKLARUESI ME SHKRIM DORE.

Në mbështetje të ligjit nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumente zyrtare” ky dokument është i hapur për publikun. Unë, deklaruesi jam në dijeni të detyrimit për rideklarim rishtazi, sipas pikës 7, të lidhjeve familjare, të gjinisë a të krushqisë, me rrethin e personave të caktuar në vendimin nr.43, datë 27.1.2006, sapo të ndryshojë ndonjë rrethanë.

**Seksioni II**

**Lidhje familjare, të gjinisë a të krushqisë,  
me drejtues të Ministrisë së Financave përfshirë edhe ministrin**

Në mbështetje të detyrimeve në fuqi, vendimit nr.43, datë 27.1.2006 të Këshillit të Ministrave “Për shmangien e nepotizmit dhe ndikimit të pushtetit në rekrutimin dhe karrierën e personelit të administratës tatimore”,

Unë, nënshkruesi \_\_\_\_\_, kandidat për t’u/ i punësuar pranë kësaj  
(emër, atësi, mbiemër)  
administratë, në detyrën \_\_\_\_\_, niveli \_\_\_\_\_, i punësuar në  
\_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_/200\_\_\_\_\_, në përgjegjësinë time të plotë, deklaroj se, \_\_\_\_\_ lidhje  
(data, muaji, viti)  
familjare, të gjinisë a të krushqisë brenda rrethit të caktuar në pikën 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.43, datë 27.1.2006, me persona të cilët ushtrojnë detyrën: drejtor drejtorie deri titullar i Ministrisë së Financave

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**Kjo deklaratë është hartuar me të  
dhënat në ditën e deklarimit**

\_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_/200\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

**Seksioni III**

**Lidhje familjare, të gjinisë a të krushqisë, me pushtetin**

Në mbështetje të detyrimeve të vendimit nr.43, datë 27.1.2006 të Këshillit të Ministrave “Për shmangien e nepotizmit dhe ndikimit të pushtetit në rekrutimin dhe karrierën e personelit të administratës tatimore”,

Unë nënshkruesi \_\_\_\_\_, kandidat për t’u/i punësuar  
(emër, atësi, mbiemër)  
pranë kësaj administratë, në detyrën \_\_\_\_\_, niveli \_\_\_\_\_  
i punësuar në \_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_/200\_\_\_\_\_, në përgjegjësinë time të plotë, deklaroj se \_\_\_\_\_ lidhje  
(data, muaji, viti)  
familjare, të gjinisë a të krushqisë me personat që kryejnë detyrat dhe funksionet shtetërore, të përcaktuara në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.43, datë 27.1.2006.

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**Kjo deklaratë është hartuar me të  
dhënat në ditën e deklarimit**

\_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_/200\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

DEKLARATA PLOTËSOHET NGA DEKLARUESI ME SHKRIM DORE.

**VENDIM**  
**Nr. 44, datë 27.1.2006**

**PËR SHMANGIEN E NEPOTIZMIT NË ADMINISTRATËN PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 2 të nenit 3 të ligjit nr.9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ndalohej të ushtrojnë detyrën brenda një institucionit publik punonjës të lidhur mes tyre me lidhje familjare, gjinie apo krushqie. Përbën shkak për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës ekzistenca e lidhjeve si më poshtë vijon:

- a) lidhje familjare: bashkëshort/bashkëjetues, bir, bijë dhe fëmijët e tyre;
- b) lidhje gjinie: prindër, motër e vëlla dhe fëmijët e tyre, emtë a ungj;
- c) lidhje krushqie: prind, fëmijë, vëlla/motër i/e bashkëshortit/es, si dhe bashkëshort/bashkëjetuesi i fëmijëve.

“Bashkëjetues, sipas shkronjave “a” e “c” të kësaj pike, është personi i cili cilësohet i tillë sipas nenit 163 të ligjit nr.9062, datë 8.5.2003 “Kodi i familjes”.

2. Personat e përzgjedhur, fitues nga konkurrimi, para fillimit të marrëdhënies së punës në institucion, deklarojnë me shkrim, sipas formularit bashkëlidhur, lidhjet familjare, të gjinisë a të krushqisë me persona të tjerë në institucion. Kur konkurrenti fitues ka lidhje me rrethin e personave të përfshirë në pikën 1 të këtij vendimi, skualifikohet si i papajtueshëm për kryerjen e detyrës.

3. Personat e punësuar në institucionin publik kanë për detyrë të rideklarojnë lidhjet familjare, të gjinisë a të krushqisë, të krijuara rishtazi në institucion, brenda 2 javësh nga lindja e detyrimit sipas kësaj pike. Titullari i institucionit ka të drejtë të ngarkojë njësinë e personelit të kryejë verifikimin e deklarimeve, kur ka të dhëna të besueshme për paraqitje rrethanash të rreme në to.

4. Në mungesë të një kërkesë me shkrim nga personat e lidhur mes tyre me lidhje familjare, gjinie a krushqie, titullari i institucionit përcakton brenda 2 javësh nga dita e depozitimit të formularit, se cili nga personat e lidhur do të qëndrojë në detyrë.

5. Deklarimi i parë i lidhjeve familjare, të gjinisë dhe të krushqisë në institucionet publike të kryhet brenda 6 javësh kalendarike nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Ekzistenca e lidhjeve familjare në institucion përbën shkak për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me njërin nga personat e lidhur mes tyre.

6. Punonjësit e skualifikuar sipas këtij vendimi trajtohen si më poshtë vijon:

a) Vendosen në listë pritjeje dhe trajtohen sipas dispozitave ligjore në fuqi, kur gëzojnë statusin e nëpunësit, në përputhje me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

b) Përfitojnë, kur kanë mbi 3 vjet vjetërsi pune të vazhdueshme në institucion, shpërblim financiar të menjëhershëm, të barabartë me pagën e 15-ditëshit, për çdo vit pune të plotë, që llogaritet në bazë të pagës që ka në përfundim të marrëdhënieve të punës, kur janë të punësuar sipas ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

7. Ky vendim e shtrin fushën e vet të veprimt në të gjitha organet e administratës publike, ku personeli trajtohet sipas ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, dhe në të gjitha institucionet e tyre të varësisë, pavarësisht nga pozicioni dhe detyra, me përjashtim:

- a) të personelit të Policisë së Shtetit që rregullohet me ligjin “Për Policinë e Shtetit”;
- b) të kategorive të caktuara të punonjësve të administratës doganore dhe tatimore, që trajtohen me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave;

c) të personelit mjekësor të shërbimit spitalor, përjashtuar punonjësi i nivelit drejtues.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Në mbështetje të ligjit nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumente zyrtare”, ky dokument është i hapur për publikun. Unë deklaruari jam në dijeni të detyrimit për rideklarim rishtazi, sipas pikës 3, të lidhjeve familjare, të gjinisë a të krushqisë, me rrethin e personave të caktuar në vendimin nr.44, datë 27.1.2003. të Këshillit të Ministrave, sapo të ndryshojë ndonjë rrethanë.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**(Emri i institucionit)**

Formular deklarami:

Deklaruesi: \_\_\_\_\_

Pozicioni: \_\_\_\_\_

Vendi i punës: (Drejtoria/Sektor) \_\_\_\_\_

**Lidhje familjare, të gjinisë a të krushqisë në institucion**

Në mbështetje të vendimit nr.44, datë 27.1.2006 të Këshillit të Ministrave “Për shmangien e nepotizmit në administratën publike”,

Unë nënshkruesi \_\_\_\_\_ kandidat/i punësuar pranë  
(emër, atësia, mbiemër)  
këtij institucioni, më datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/200\_\_\_\_, nën përgjegjësinë time të plotë, deklaroj se  
(data, muaji, viti)

\_\_\_\_\_ lidhje familjare, të gjinisë a të krushqisë, si ato të përcaktuara në pikën 1 të vendimit, me persona punonjës deri titullar i këtij institucioni \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Kjo deklaratë është hartuar me të  
dhënat në ditën e deklaramit

\_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_/200\_\_\_\_

Nënshkruesi \_\_\_\_\_

DEKLARATA PLOTËSISHT NGA DEKLARUESI ME SHKRIM DORE.

**VENDIM**  
**Nr. 47, datë 27.1.2006**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.205, DATË 13.4.1999 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË KODIT DOGANOR”, TË**  
**NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 32 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shkronjat “a”-“h” të pikës 49.3 shfuqizohen dhe zëvendësohen me shkronjat “a”-“1”, si më poshtë vijon:

“a) operacione ruajtjeje, për të siguruar se produktet do të vazhdojnë të jenë në kushte të mira gjatë transportit dhe magazinimit;

b) thyerja dhe bashkimi i paketimeve;

c) larja, pastrimi, heqja e pluhurit, e oksideve, vajit, bojës apo mbulimeve të tjera;

ç) hekurosja apo presimi i tekstileve;

d) operacione të thjeshta lyerjeje dhe ndriçimi;

dh) shoshitja, bluarja e pjesshme apo e përgjithshme, ndriçimi dhe shkëlqimi i farërave dhe i orizit;

e) operacione për të ngjyrosur sheqerin apo për të krijuar forma sheqeri, bluarje të pjesshme apo të plotë të sheqerit;

ë) heqja e lëkurës, ngurtësimi dhe veshja e frutave, arrave dhe perimeve;

f) mprehja, prerja e thjeshtë apo thelëzimi i thjeshtë;

g) ndarja, përzgjedhja, mbulimi, klasifikimi, gradimi, ngjasimi (duke përfshirë krijimin e kompleteve të mallrave);

gj) vendosja e thjeshtë në shishe, konserva, faqore, çanta, kuti, ngjitja e kartave apo e mbështjellëseve dhe të gjitha operacionet e tjera të thjeshta të paketimit;

h) ngjitja apo printimi i treguesve, etiketave, logove dhe shenjave të tjera të ngjashme, dalluese, mbi produktet apo paketimet e tyre;

i) përzierja e thjeshtë e produkteve, duke qenë ose jo të llojeve të ndryshme, kur një apo më tepër përbërës të përzierjes nuk përmbushin kriteret e paraqitura në këtë seksion, për t’u mundësuar atyre të vlerësohen si të origjinës në një vend përfitues, në një territor ose në komunitet;

j) bashkimi i thjeshtë i pjesëve të mallrave, për të përbërë një material të plotë ose ndarje të produkteve në pjesë;

k) një kombinim i dy ose më tepër operacioneve të specifikuara në shkronjat “a” deri në “j”;

l) therrja e kafshëve.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr. 48, datë 27.1.2006**

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.205, DATË 13.4.1999 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E DISPOZITAVE ZBATUESE TË KODIT DOGANOR**  
**TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, 14 e 16 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në kreun III të vendimit nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesat si më poshtë vijon:

1. Pas pikës “11.1”, shtohen pikat “11.1.1”, “11.1.1.a”, “11.1.1.b”, “11.1.1.c”, “11.1.1.ç”, “11.1.1.d”, “11.1.1.e”, “11.1.1.ë” dhe “11.1.1.f”, me këtë përmbajtje:

“11.1.1 Rekrutimi i personelit doganor kryhet nëpërmjet përzgjedhjes së konkurrentëve nga rrethi i personave, që përmbushin kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendit të punës, në përputhje me procedurat sipas pikës 11.1 të këtij kreu. Konkurrentët ose personeli doganor për kategoritë: drejtues i nivelit të lartë, nëpunës të kategorisë “A”, “B”, “C1”, “C2” apo “C3”, skualifikohen ose humbin të drejtën e vendit të punës, në rast se për ta ekzistojnë apo, pas emërtimit, lindin shkaqet ligjore të papajtueshmërisë për shkak të:

- a) lidhjeve nepotike ose
- b) lidhjeve nepotike me pushtetin.

11.1.1.a Lidhje nepotike janë lidhjet e mëposhtme ndërmjet konkurrentëve apo nëpunësve të administratës doganore, të kategorive të përcaktuara në pikën 11.1.1 të këtij kreu, me të gjithë personelin e administratës doganore, deri në nivelin e drejtuesit të institucionit, ku bëjnë pjesë, si dhe me drejtorët, deri në nivelin e titullarit të institucionit epror:

- a) lidhje familjare: bashkëshort/bashkëjetues, bir, bijë dhe fëmijët e tyre;
- b) lidhje gjinie: prindër, motër a vëlla dhe fëmijët e tyre, emtë a ungj;

c) lidhje krushqie: prind, fëmijë, vëlla/motër i/e bashkëshortit/es, si dhe bashkëshort/bashkëjetues i fëmijëve.

“Bashkëjetues”, sipas shkronave “a” e “c” të kësaj pike, është personi i cili cilësohet i tillë sipas nenit 163 të ligjit nr.9062, datë 8.5.2003 “Kodi i Familjes”.

11.1.1.b Lidhje nepotike me pushtetin ekzistojnë apo lindin kur konkurrentët apo nëpunësit e administratës doganore, të kategorive të përcaktuara në pikën “11.1.1” të këtij kreu, kanë apo krijojnë lidhje nepotike nga ato të përcaktuara në pikën “11.1.1.a” të këtij kreu me:

- a) Presidentin e Republikës dhe stafin e tij politik;
- b) Kryeministrin, zëvendëskryeministrin, ministrat dhe zëvendësministrat;
- c) anëtarët e stafit politik të Kryeministrit dhe të Ministrit të Financave;
- ç) deputetët;

d) titullarët e institucioneve: Avokati i Popullit, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Prokuroria e Përgjithshme;

- e) titullarët e institucioneve qendrore, të pavarura;

ë) titullarët e institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit dhe të Ministrit të Financave;

f) drejtuesin e Policisë së Shtetit dhe zëvendësit e tij;

g) prefektin, kryetarin e bashkisë, kryetarin e këshillit bashkiak dhe të këshillit të qarkut, kryetarin e gjykatës së rrethit gjyqësor, prokurorin e rrethit gjyqësor, drejtorin e policisë së qarkut, për administratën doganore, që vepron brenda territorit përkatës.

11.1.1.c Konkurrentët fitues në kategoritë e përcaktuara në pikën 11.1.1 të këtij kreu, para fillimit të marrëdhënies së punës, deklarojnë me shkrim lidhjet për pikat 11.1.1.a e 11.1.1.b të këtij kreu. Kur konkurenti fitues ka lidhje nepotike apo lidhje nepotike me pushtetin sipas pikave 11.1.1.a dhe 11.1.1.b të këtij kreu, skualifikohet si i papajtueshëm për të kryer detyrën.

11.1.1.ç Drejtoria e personelit, para kryerjes së testimit për çdo vend pune, vendos në dispozicion të konkurruesve të dhënat për identitetin e të gjithë personelit deri te titullari i tij, si dhe identitetin e drejtorëve deri në nivelin e titullarit të institucionit epror, për pozicionin vakant të punës.

11.1.1.d Nëpunësit e administratës doganore të kategorive të përcaktuara në pikën 11.1.1 të këtij kreu kanë për detyrë të rideklorojnë lidhjet nepotike ose lidhjet nepotike me pushtetin, të krijuara rishtazi, brenda 2 javësh nga lindja e detyrimit sipas kësaj pike. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave ka të drejtë të ngarkojë drejtorinë e personelit të kryejë verifikimin e të dhënave të deklaruara, kur ka të dhëna të besueshme për paraqitje rrethanash të rreme në to.

11.1.1.e Verifikimi i parë i lidhjeve nepotike a lidhjeve nepotike me pushtetin bëhet brenda 6 javësh kalendarike nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Në verifikimin e parë, nëpunësit duhet të deklarojnë lidhjet e pushtetit me pushtetarët, sipas listës së funksioneve të paraqitura në pikën 11.1.1.b, në çastin e deklarimit dhe, në rast se rekrutimi i tyre është bërë në një periudhë jo më herët se katër vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, edhe me pushtetarët sipas listës së funksioneve të paraqitura në pikën 11.1.1.b, në çastin e rekrutimit. Ekzistenca e lidhjeve nepotike a të lidhjeve nepotike me pushtetin, sipas kësaj pike, është shkak për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.

11.1.1.ë Nëpunësit e administratës doganore, të skualifikuar sipas këtij vendimi në çastin e lirit nga detyra, përfitojnë, nëse kanë mbi 3 vjet vjetërsi pune të vazhdueshme në këtë administratë, një shpërbtim financiar të barabartë me pagën e 15-ditëshit, për çdo vit pune të plotë, që llogaritet në bazë të pagës, që ka në përfundim të marrëdhënieve të punës.

11.1.1.f Nëpunësit e administratës doganore të kategorive të përcaktuara në pikën 11.1.1. të këtij kreu, i dorëzojnë drejtorisë së personelit të institucionit deklaratat e plotësuar për lidhjet nepotike ose lidhjet nepotike me pushtetin, sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

2. Ngarkohet Ministri i Financave që brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore për zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Në mbështetje të ligjit nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumente zyrtare”, ky dokument është i hapur për publikun. Unë deklaruësi jam në dijeni të detyrimit sipas kreut III pika 11.1.1. ç të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.205, datë 13.4.1999, të ndryshuar, për rideklarim rishtazi, të lidhjeve familjare, të gjinisë a të krushqisë, me rrethin e personave të caktuar, sapo të ndryshojë ndonjë rrethanë.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
(Emri i institucionit)

Formular deklarami:

Deklaruesi: \_\_\_\_\_

Pozicioni: \_\_\_\_\_

Vendi i punës: (Drejtoria/ sektori) \_\_\_\_\_

**Seksioni I**

***Lidhje familjare, të gjinisë a të krushqisë,  
me punonjës të tjerë të administratës doganore***

Në mbështetje të detyrimeve në fuqi të vendimit nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor”, të ndryshuar, kreut III pika 11.1.1 dhe 11.1.1.a.,

unë nënshkruesi \_\_\_\_\_, kandidat për t’u/i  
(emër, atësia, mbiemër)

punësuar, pranë kësaj administrate, në detyrën \_\_\_\_\_ kategoria \_\_\_\_\_ i punësuar në \_\_\_\_/\_\_\_\_/200\_\_\_\_, nën përgjegjësinë time të plotë, deklaroj se \_\_\_\_\_ lidhje  
(data, muaji, viti)

familjare, të gjinisë a të krushqisë, me personelin e administratës doganore brenda rrethit të personave të caktuar në pikën 11.1.1.a të këtij vendimi:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Kjo deklaratë është hartuar me të  
dhënat në ditën e deklaramit

\_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_/200\_\_\_\_

Nënshkruesi \_\_\_\_\_

DEKLARATA PLOTËSOHET NGA DEKLARUESI ME SHKRIM DORE.

Në mbështetje të ligjit nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumente zyrtare”, ky dokument është i hapur për publikun. Unë deklaruësi jam në dijeni të detyrimit sipas kreut III pika 11.1.1. ç të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.205, datë 13.4.1999, të ndryshuar, për rideklarim rishtazi, të lidhjeve familjare, të gjinisë a të krushqisë, me rrethin e personave të caktuar, sapo të ndryshojë ndonjë rrethanë.

### **Seksioni II**

***Lidhje familjare, të gjinisë a të krushqisë,  
me drejtues të Ministrisë së Financave, përfshirë edhe Ministrin***

Në mbështetje të detyrimeve në fuqi të vendimit nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor”, të ndryshuar, kreut III pika 11.1.1 dhe 11.1.1.a. unë nënshkruësi \_\_\_\_\_ kandidat për t’u/i punësuar,

(emër, atësia, mbiemër)

pranë kësaj administrate, në detyrën \_\_\_\_\_ kategoria \_\_\_\_\_ i punësuar në \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_ /200\_\_\_\_\_, nën përgjegjësinë time të plotë, deklaroj se \_\_\_\_\_ lidhje  
(data, muaji, viti)

familjare, të gjinisë a të krushqisë, të përcaktuar në kreun III pika 11.1.1.a të këtij vendimi me personat që ushtrojnë detyrën, drejtor drejtorie deri titullar i Ministrisë së Financës.

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit

\_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_ /200\_\_\_\_\_

Nënshkruësi \_\_\_\_\_

### **Seksioni III**

***Lidhje familjare, të gjinisë a të krushqisë,  
me pushtetin***

Në mbështetje të detyrimeve në fuqi të vendimit nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor”, të ndryshuar, kreut III pika 11.1.1, 11.1.1.a e 11.1.1.b

unë nënshkruësi \_\_\_\_\_ kandidat për t’u/i punësuar, pranë  
(emër, atësia, mbiemër)

kësaj administrate, në detyrën \_\_\_\_\_ kategoria \_\_\_\_\_ i punësuar në \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_ /200\_\_\_\_\_,  
(data, muaji, viti)

nën përgjegjësinë time të plotë, deklaroj se \_\_\_\_\_ lidhje familjare, të gjinisë a të krushqisë brenda rrethit të caktuar në pikën 11.1.1.a të këtij vendimi me personat që kryejnë detyrat dhe funksionet shtetërore, të përcaktuara në kreun III pika 11.1.1.b

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit

\_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_ /200\_\_\_\_\_

Nënshkruësi \_\_\_\_\_

DEKLARATA PLOTËSOHET NGA DEKLARUESI ME SHKRIM DORE.

**VENDIM**  
**Nr. 52, datë 27.1.2006**

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË ÇMIMEVE  
TË BARNAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 50 e 51 të ligjit nr.9323, datë 25.11.2004 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ngritjen e Komisionit të Çmimeve të Barnave, pranë Ministrisë së Shëndetësisë, të përbërë nga kryetari dhe 8 anëtarë, përfaqësues të:

- Ministrisë së Shëndetësisë	kryetari dhe 2 anëtarë
- Ministrisë së Financave	1 anëtar
- Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	1 anëtar
- Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor	2 anëtarë
- Urdhrit të Farmacistëve	1 anëtar
- Shoqatës së Pacientëve të Shqipërisë	1 anëtar.

2. Drejtoria Farmaceutike, në Ministrinë e Shëndetësisë, brenda muajit dhjetor të çdo viti, të paraqesë pranë Komisionit të Çmimeve të Barnave, të dhëna për çmimet e barnave, të fabrikuar në vend dhe për ato të importuara.

3. Komisioni i Çmimeve të Barnave të kryejë procesin e negociimit me fabrikuesit, vendas e të huaj, e me përfaqësitë farmaceutike në vendin tonë, të hartojë listën e përgjithshme të çmimeve të barnave të regjistruara dhe t'ia paraqesë Ministrit të Shëndetësisë, i cili e propozon për miratim në Këshillin e Ministrave, brenda tremujorit të parë të çdo viti kalendarik.

4. Çdo anëtar i Komisionit të Çmimeve të Barnave të shpërblehet me 5 000 (pesë mijë) lekë për pjesëmarrje në mbledhje, por masa e shpërblimit mujor nuk duhet të jetë më shumë se 5 000 (pesë mijë) lekë.

5. Efektet financiare për shpërblimin e anëtarëve të Komisionit, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë.

6. Vendimi nr.241, datë 18.5.2000 i Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, shfuqizohet.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr. 56, datë 1.2.2006**

**PËR NDRYSHIMIN E PËRBËRJES SË KËSHILLAVE TË PËRFAQËSUESVE TË  
BORDEVE TË KULLIMIT, NË ZONAT E SHËRBIMIT TË KULLIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 “Për ujitjen dhe kullimin”, dhe të nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Këshilli i Përfaqësuesve të Bordit të Kullimit, në zonat e shërbimit të kullimit, Berat, Dibër, Durrës-Krujë, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Peqin-Kavajë, Korçë, Kukës, Lezhë-Kurbin, Lushnjë, Sarandë, Shkodër, Pogradec, Tiranë, Vlorë, të krijuara me vendime të Këshillit të Ministrave, të përbëhet nga:

- a) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
  - b) 2 (dy) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
  - c) 2 (dy) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
  - ç) 1 (një) përfaqësues i bashkive, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
  - d) 1 (një) përfaqësues i këshillit të qarkut.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**UDHËZIM**  
**Nr. 2, datë 27.1.2006**

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 1.1.1996 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR PROKURIMIN PUBLIK”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**UDHËZON:**

Në kapitullin VI “Komisioni i vlerësimit të ofertave dhe njësia e prokurimit (hartuesit e dokumenteve të tenderit)” të udhëzimit nr.1, datë 1.1.1996 të Këshillit të Ministrave “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, pas paragrafit të parë të shtohet teksti, me këtë përmbajtje:

“Anëtarët e njësisë së prokurimit dhe të komisionit të vlerësimit të ofertave përzgjidhen ndërmjet personave, të cilët nuk kanë lidhje:

i) familjare: bashkëshort/bashkëjetues, bir/bijë dhe fëmijët e tyre;  
ii) gjinie: prindër, motër a vëlla dhe fëmijët e tyre, emtë a ungj;  
iii) krushqie: prind, fëmijë, vëlla/motër i/e bashkëshortit/es, si dhe bashkëshort/bashkëjetues i fëmijëve, me personat që ushtrojnë detyra a funksione shtetërore:

a) President i Republikës dhe stafi i tij politik;  
b) Kryeministrin, zëvendëskryeministrin, ministrat dhe zëvendësministrat;  
c) anëtar i stafit politik të Kryeministrit;  
ç) deputet;  
d) titullar i institucioneve të: Avokatit të Popullit, Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Prokurorisë së Përgjithshme;

dh) titullar i institucioneve qendrore, të pavarura;  
e) titullar i institucioneve qendrore në varësi të Kryeministrit;  
ë) drejtues i Policisë së Shtetit dhe zëvendësi i tij;  
f) kryetar bashkie, kryetar i këshillave bashkiake a i këshillit të qarkut, për ente prokuruese me vendndodhje brenda njësisë së bashkisë ose qarkut;

g) prefekt, kryetar i gjykatës së rrethit gjyqësor të shkallës së parë, prokuror i rrethit gjyqësor, drejtor i policisë së qarkut, për entet prokuruese me vendndodhje brenda njësisë së bashkisë ose qarkut;

gj) prokuror pranë prokurorisë së gjykatave të shkallës së parë, për ente prokuruese, për të cilat, për shkak të vendndodhjes, prokurori ka kompetencë territoriale të fillojë, ushtrojë apo mbarojë hetimin.

“Bashkëjetues” është personi, i cili cilësohet i tillë sipas nenit 163 të ligjit nr.9062, datë 8.5.2003 “Kodi i Familjes”.

Personat e caktuar ushtrojnë përgjegjësitë si anëtarë të njësisë së prokurimit a të komisionit të vlerësimit të ofertave, vetëm kur kanë plotësuar dhe depozituar më parë, pranë titullarit të entit, formularin e lidhjeve nepotike me pushtetin, sipas tekstit bashkëlidhur. Plotësimi i formularit kryhet për çdo tender. Formulari administrohet dhe vendoset në ruajtje, së bashku me dokumentacionin e prokurimit. Punonjësi i entit ose personi i jashtëm mban përgjegjësi personale dhe lirohet menjëherë nga detyra që kryhen, nëse nga një kontroll i ushtruar ose nga informacionet e mbërritura në ent rezulton se ai ka kryer deklarime të pavërteta, pavarësisht ligjshmërisë apo rregullsisë së veprimeve të tij në tender.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Në mbështetje të ligjit nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumente zyrtare”, ky dokument është i hapur për publikun.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI PROKURUES**

Formular deklarimi:

Deklaruesi: \_\_\_\_\_

Pozicioni: \_\_\_\_\_

Vendi i punës: (Drejtoria/sektori) \_\_\_\_\_

Në mbështetje të udhëzimit nr.1, datë 1.1.1996 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar,  
unë nënshkruesi \_\_\_\_\_, kandidat për anëtar  
(emër, atësia, mbiemër)  
në njësinë e prokurimit/komisionin e vlerësimit të ofertave, sipas urdhrin nr. \_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_,  
të titullarit të institucionit bashkëlidhur, sot më datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/200\_\_\_\_.  
(data, muaji, viti)

nën përgjegjësinë time të plotë, deklaroj se:

\_\_\_\_\_ lidhje familjare, të gjinisë a të krushqisë, brenda rrethit të personave  
me pushtet të caktuar në kapitullin IV të këtij udhëzimi:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Kjo deklaratë është hartuar me të  
dhënat në ditën e deklarimit

\_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_/200\_\_\_\_

Nënshkruesi \_\_\_\_\_

DEKLARATA PLOTËSOHET NGA DEKLARUESI ME SHKRIM DORE.

**Fletorja Zyrtare gjendet:**

- duke u abonuar pranë njërive postare të qyteteve ose
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare; në adresën:  
Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot" Tel: 042 555 63; 267 468

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

**REGJISTRAT E NOTERISË SIPAS FORMATIT TË MIRATUAR  
NGA MINISTRIA E DREJTËSISË 2005**

1. REGJISTRI I PËRGJITHSHËM I AKTEVE DHE I VEPRIMEVE NOTERIALE ...	1000
2. REGJISTRI I TESTAMENTEVE .....	500
3. REGJISTRI I DEPOZITIMIT TË PARAVE OSE VLERAVE TË TJERA .....	500
4. INDEKSI ALFABETIK .....	600

**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK.....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (Botim, 2005) .....	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë).....	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET.....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004 ...	1500
2. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004.....	2000

**BOTIME TË REJA**

1. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim i II-të)	1500
2. KODI DOGANOR.....	1000
3. KODI DETAR .....	1000

Doli nga shtypi më 7.2.2006

Tirazhi: 4000 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2006

Çmimi: 150 lekë